



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. _____ Prot.

Date ____/____/2021

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 09/02/2021

Për: Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PIRRAÇI-U6” Shpk & “NG STRUCTURES” Shpk, me adrese: Valias prane rruges Nacion, Tirane.

Procedura e prokurimit: **E Hapur/ Pune.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-83105-12-24-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Permiresimi i Infrastruktures dhe Sigurise ne shetitoren e Lumit "Drin", Lezhe (Ndertimi i 2 Urave)”**.

Kohëzgjatja e kontratës: **6 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “KOLOSEU” Shpk, me Nuis J72603129H, me ofertë ekonomike 28,252,000 (njetzet e tete milion e dyqind e pesedhjetete e dy mije) Lek pa Tvsh.
- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PIRRAÇI-U6” Shpk, me Nuis K62408008V & “NG STRUCTURES” Shpk, me Nuis L79326502O, me ofertë ekonomike 31,498,151 (tridhjetete e nje milion e katërqind e nentendhjetete e tetëmijë e njëqind e pesedhjetete e nje) Lek pa Tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1- Operatori Ekonomik “KOLOSEU” Shpk, me Nuis J72603129H, me ofertë ekonomike 28,252,000 (njetzet e tete milion e dyqind e pesedhjetete e dy mije) Lek pa Tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I- Operatori Ekonomik “KOLOSEU” Shpk, me Nuis J72603129H.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, ne Kriteret e veçanta të kualifikimit shkronja (gj), parashikohet se: Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Nga verifikimi rezulton se operatori nuk ka paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e energjisë elektrike.

Se dyti, nuk permbush kerkesat e pikes 2.2, te kerkuar ne DST, ne lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, pasi OE nuk ka dorezuar ne SPE: **Vertetim Xhiro**, per tre vitet e fundit; **Kopjet te bilanceve per vitet 2017, 2018 dhe 2019**, si dhe vertetimin se subjekti ka paguar të gjitha **detyrimet e maturuara te taksave dhe tarifave vendore.**

Se treti, nuk permbush kerkesat e pikes 2.3.1, te kerkuar ne DST, ne lidhje me kapacitetin teknik, pasi OE nuk ka dorezuar ne SPE, asnje dokumentacion qe provon se OE ka pervojte te sukseshme ne realizimin e puneve te ngjashme, si ne sektorin publik dhe privat.

Se katerti, ne piken 2.3.2, parashikohet se: Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur Licence profesionale per zbatimin e punimeve ne ndërtim.

Se pesti, ne piken 2.3.3, parashikohet se: Operatori duhet të dëshmoje se ka të punësuar mesatarisht të paktën 35 (*tridhjetë e pese*) punonjës, me kohë të plotë, për periudhën Qershor 2020 – Nentor 2020;

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se OE ka te punesuar mesatarisht **16** (gjashtembedhjetë) punonjes per periudhen Qershor 2020-Nentor 2020, duke mos permbushur kriterin e kerkuar ne DST.

Se gjashti, ne piken 2.3.4, parashikohet se: Operatori Ekonomik duhet te kete pjese te stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise: 1 (nje) Ing. Ndertimi, profili strukturist dhe 1 (nje) Ing. Gjeodet (Topograf). Kjo pike konsiderohet e pa permbushur, pasi OE nuk ka ngarkuar ne SPE Licensen e Shoqerise e cila ka te pasqyruar drejtuesit teknik.

Se shtati, nuk eshte permbushur pika 2.3.6, pasi nuk ka ngarkuar ne SPE, dokumentacion qe provon disponueshmerine e mjekut.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, vendosi të refuzojë ofertën e **OE “KOLOSEU” Shpk**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. të ndryshuar, Operatori Ekonomik “KOLOSEU” Shpk, me Nuis J72603129H, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “PIRRAÇI-U6” Shpk & “NG STRUCTURES” Shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 31,498,151 (tridhjetë e një milion e katërqind e nentëdhjetë e tetëmijë e njëqind e pesëdhjetë e një) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe sigurimin e kontratës dhe dokumentacionin e tenderit të noterizuar, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01/02/2021.

Ankesa: Nuk Ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

K R Y E T A R I

Pjerin NDREU